

Konsensusi ndërpartiak i shqiptarëve të Kosovës për dialogun Prishtinë-Beograd

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar më 10 dhjetor 2012 në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për përfaqësues të partive parlamentare të shqiptarëve të Kosovës, për zyrtarët qeveritarë dhe anëtarë të shoqërisë civile duke përfshirë organizatat lokale joqeveritare dhe mediat.

Diskutimi ka ofruar mundësinë që pjesëmarrësit t'i shkëmbejnë opinionet e tyre në një takim joformal për dialogun në zhvillim e sipër mes Prishtinës e Beogradit. Pjesëmarrësit kanë identifikuar disa nga dallimet mes partive shqiptare sa i përket dialogut me Beogradin dhe kanë artikulluar dhe propozuar ndërmarrjen e një numri hapash për zvogëlimin e këtyre dallimeve. Ata poashtu kanë adresuar çështjen e dialogut nga një këndvështrim më tënkin, duke shqyrtuar temat të cilat, sipas tyre, duhet ose nuk duhet të diskutohen me Serbinë. Një tjetër pikë e diskutimit ka qenë edhe ajo për mënyrat në të cilat shoqëria civile e Kosovës mund të kontribuojë në këtë dialog.

Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë tryezë të rrumbullakët në emrin e tyre personal dhe pikëpamjet e tyre jodomosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet apo qëndrimet e organizatave të cilat i përfaqësojnë. Ky raport nuk ofron një përshkrim të kompletuar të diskutimeve. Raporti nuk është lexuar nga pjesëmarrësit dhe CIG është përgjegjës për përmbajtjen. Raporti është përgatitur nga Arber Kuci, koordinator i programit në Kosovë i CIG.

Konsensusi ndërpartiak për dialogun Prishtinë-Beograd

Pjesëmarrësit e kanë vlerësuar procesin dhe rezultatet e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit. Padyshim, tema kryesore e diskutimit ka qenë marrëveshja rreth menaxhimit të integruar të kufijve, të njohur me shkurtesën IBM. Ka ekzistuar një konsensus se kjo marrëveshje, si edhe marrëveshjet e arritura më parë gjatë “bisedimeve teknike”, nëse do të implementoheshin, do të përmirësonin jetën e qytetarëve. Implementimi i fazës së parë të marrëveshjes në dy pikat kufitare ka filluar ditën kur po mbahej kjo tryezë e rrumbullakët.

Një pjesëmarrës ka thënë se partitë politike të shqiptarëve të Kosovës jodomosdoshmërisht janë kundër dialogut dhe nevojës për te, por nuk pajtohen rreth formatit dhe kushteve në të cilat bazohet ai. Ata të cilët kundërshtojnë dialogun e

tanishëm, poashtu besojnë se ai nuk është duke prodhuar rezultate. Së këndejmi, ekziston konsensusi për dialog me Beogradin, me dallime vetëm rreth çështjeve të cilat duhet të diskutohen dhe mënyrës së si duhet të adresohen ato. Sipas këtij pjesëmarrësi, ky pozicionim i partive politike ka ardhur si pasojë e mungesës së informatave dhe transparencës nga ana e qeverisë së Kosovës. Deri më tani, qeveria nuk ka shpjeguar se në çfare kapacitetesh marrin pjesë Kosova dhe Serbia në dialog; a është ky proces mes shteteve apo mes individëve? Ky pjesëmarrës poashtu ka theksuar faktin se nuk ka pasë kurrfarë debati para fillimit të këtij procesi dhe, si pasojë, shumë nga akterët në spektrin politik ndjehen të lënë anash apo të eliminuar nga procesi. Marrëveshja e IBM-it, sipas këtij pjesëmarrësi, i kontribuon edhe më tej mjegullës dhe e bën tërë procesin edhe më pak transparent. Ai ka justifikuar ata të cilët vënë në pikëpyetje nevojën për një marrëveshje të tillë, duke thënë se kufijtë e Kosovës kanë qenë të njohur nga Jugosllavia, Republika e Serbisë, rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-së, plani Ahtisaarit dhe kushtetuta e Kosovës. “Cka është IBM? Vetëm një vendkalim apo kalim kufitar? Nuk është asnjëra, dhe ka shumë paqartësi se si është duke u interpretuar” ka thënë ky pjesëmarrës, duke stuar se një proces i tillë mund të jetë ckado tjetër përvec proces i vërtetë i normalizimit të marrëdhënieve, një qëllim i përgjithshëm i dialogut të sponzorizuar nga BE-ja. “Ne duhet të zvogëlojmë paqartësitë”, ka konkluduar ky pjesëmarrës.

Pjesëmarrësit e tjerë janë pajtuar që të folurit për konsensusin në kushtet e tanishme do të ishte paksa i vështirë. Njëri nga ta ka cuar diskutimin edhe më tej, duke thënë se “ne duhet poashtu të diskutojmë nëse konsensusi është i nevojshëm e jo vetëm nëse është i arritshëm”. Gjykuar nga ajo se si është zhvilluar procesi deri tani, nuk pritet të ketë unitet apo platform të përbashkët ndërmjet partive politike të Kosovës, kryesisht pasi që asnjë qeveri nuk dëshiron të ndajë me partitë opozitare meritat dhe të mirat e dialogut. “Dialogu do t’i mbajë në pushtet politikanët e tanishëm”, ka thënë ai.

Por qeveritë në Prishtinë dhe Berograd, të cilat janë duke u ballafaquar me menaxhimin e procesit para votuesve të tyre dhe publikut në përgjithësi. Në Kosovë, qeveria ka qenë në gjendje ta shkund tokën nën këmbët e opozitës që dikur dukej sikur është shumë e vendosur në kundërshtimin ndaj dialogut. Partitë opozitare nuk janë kundër dialogut por kundër formatit të këtij dialogu. Ata thonë se Kosova nuk është e përfaqësuar si shtet i pavarur dhe se deri tash ka bërë kompromise që minojnë sovranitetin e saj dhe japin më shumë përfitime për Beogradin se sa për Prishtinën. Një nga pjesëmarrësit është pajtuar se Kosova nuk ka përfituar shumë nga dialogu dhe se Prishtina vazhdon të mbështetet shumë në komunitetin ndërkombëtar. “Dhjetë vitet e kaluara kanë qenë në favor të Kosovës, tash kjo ka ndryshuar dhe koha po punon në favor të Serbisë”, ka thënë ai, duke shtuar se Serbia mund të marrë datën e bisedave për anëtarësim në BE “pa bërë shumë”.

Një numër i pjesëmarrësve kanë qenë të mendimit se përfitimet, sic janë lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve si dhe implementimi i plotë dhe i shpejtë i marrëveshjeve do të absorbonte pakënaqësinë e partive opozitare në Kosovë dhe Serbi. Një efekt negativ i mundshëm mund të jetë pranimi jo i mirë nga serbët në veri. Pjesëmarrësit kanë qenë optimist se edhe në një rast të tillë, dialogu nuk do të dëmtohej dhe nuk do të rrezikohet në mënyrë serioze.

Qeveria e Kosovës, sipas shumë pjesëmarrësve, ka qenë e paafte në formimin e një opinionit publik në favor të dialogut. Argumenti kryesor që në favor të dialogut që i është paraqitur publikut ka qenë ai i cili thotë se dialogu i ndihmon Kosovës t'i afrohet anëtarësimit në BE. Sipas këtij argumenti, nëse Kosova angazhohet në proces ajo do t'i afrohej edhe më tej integritetit evropian dhe në afat më të gjatë do të merrte njohjen edhe nga Beogradi. Pjesëmarrësit tjerë kanë thënë se këto janë rezultate shumë të paprekshme dhe se publiku në Kosovë është i vetëdijshëm se këto synime nuk do të arrihen përmes dialogut por duke adresuar një listë të gjatë të çështjeve të rëndësishme të cilat në mënyrë negative ndikojnë në funksionimin e shtetit.

Një pjesëmarrës tjetër ka thënë se dialogu është duke u shfrytëzuar nga qeveria me qëllim të mosballafaqimit me çështje më të rëndësishme dhe më të vështira, sic janë papunësia, korrupsioni, zhvillimi ekonomik dhe vjedhjet e zgjedhjeve. Por, edhe pretendimet e qeverisë se përmes dialogut Serbia eventualisht do ta njohë Kosovën janë në kundërshtim me situatën reale. Sipas këtij folësi, largimi i shenjës “Mirësevini në Kosovë” në njërën nga pikat kufitare si pjesë e marrëveshjes IBM do të thotë se ky dialog njeh të drejtën e Serbisë për mos e njohur shtetin e Kosovës. Për më shumë, sipas tij, komuniteti ndërkombëtar nuk është i interesuar ti shpërbëjë institucionet paralele të Serbisë në veri, por t'i transformojë ato në institucione të pranuar legalisht. Një gjë e tillë do të siguronte një nivel të caktuar të autonomisë për veriun të cilin do ta pranonte edhe Kosova e edhe Serbia, dhe e cila do t'i mundësonte Serbisë suksesin në rrugën e saj drejt integritetit në BE. Pra, në thelb, sipas këtij pjesëmarrësi, ky nuk është një proces i vërtetë për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve. Fajin për këtë e ka edhe qeveria e Kosovës e cila nuk ka qenë në gjendje që ta diskutojë me hisëdarët tjerë interesin nacional të Kosovës dhe të dalë me një platformë të saj në të cilën do të bazohej dialogu. “Ne kurrë nuk flasim se si mund ti ndihmojmë Brukselit që ai të na ndihmojë neve”, ka konkluduar ky folës.

Një nga pjesëmarrësit ka thënë se Kosova nuk duhet të hyjë fare në këtë dialog për atë kohë sa Serbia nuk kërkon falje për krimet që i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Sipas këtij folësi, Serbia duhet gjithashtu t'i kthejë të gjitha pronat e vjedhura nga Kosova dhe në fund ta rrespektojë shtetësinë e Kosovës. Një tjetër pjesëmarrës u pajtua, duke thënë se librat e kadastrës të cilat janë vjedhur në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999 duhet të kthehen si shenjë e vullnetit të mirë. “Nuk duhet të mbahen negociata rreth kësaj teme, ato i takojnë Kosovës”, ka thënë ai. Një pjesëmarrës tjetër ka rekomanduar që Serbia duhet ta largojë nga preambula e kushtetutës së saj përmendjen e Kosovës si pjesë të territorit të saj. Një pjesëmarrës tjetër, megjithatë, ka thënë se këto qasje, sado të dëshiruara, duhet të marrin parasysh involvimin e dy faktorëve kryesorë ndërkombëtar, SHBA-të dhe BE-në. Ai ka theksuar se kontributi i tyre në këtë proces nuk duhet të harrohet se angazhimi i tyre në asnjë rast nuk duhet të merret i qenë.

Në vend se të adresohen përmes dialogut, disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se çështja e veriut është e lidhur me çështjen e sundimit të ligjit. Disa kanë thënë se sikur edhe në pjesët tjera të Kosovës, veriu është arenë e aktiviteteve të vazhdueshme kriminale dhe rrjeteve kriminale të cilat duhet të adresohen përmes instrumenteve të forcës së shtetit.

Shumica e pjesëmarrësve kanë përmendur gjyqësorin funksional si institucionin kyç që ka nevojë për t'u ringjallur. Në lidhje me sundimin e ligjit, një nga pjesëmarrësit ka shprehur skpticizmin e tij për politikanët dhe udhëheqësit e Kosovës. Sipas tij, edhe sikur dialogu të ishte një proces i mirë, individët të cilët përfaqësojnë Kosovën në të nuk janë të besueshëm. “Ata mund të shantazhohen për shkak të veprimeve të tyre”, ka thënë ai.

Përfundim

Gjatë diskutimit ka ekzistuar një pajtueshmëri e përgjithshme se implemetimi i marrëveshjeve të arritura deri më tani do të tregojë nëse dialogu është një instrument i vërtetë për eliminimin e pengesave ekonomike e politike mes Kosovës e Serbisë. Marrëveshja e IBM-së ka filluar të implementohet dhe, deri tani, ajo është implementuar në dy pika kufitare. Pjesëmarrësit janë pajtuar se marrëveshja e bën ndarjen më pak të mundshme, por nuk i përjashton mundësitë tjera sic është ajo e autonomisë për veriun.

Qeveria e Kosovës ka qenë e paaftë për të formuar një opinion publik në favor të dialogut, edhe pse ka qenë e suksesshme që disa nga partitë opozitare t'i kthejë në mbështetës të tij, parti këto të cilat deri vonë kanë qenë kundërshtarë të flaktë të dialogut. Për shkak të involvimit aktiv të BE-së dhe SHBA-së në këtë proces, ka ekzistuar një pajtueshmëri e përgjithshme në mesin e pjesëmarrësve se dialogu është një fakt dhe se është paksa jorealiste të pritet që ai të përfundojë pa u diskutuar çështja e veriut. Sipas pjesëmarrësve, në vend se të fokusohet në atë se a është dialogu i nevojshëm apo në favor të Kosovës, Kosova duhet të fokusohet në përmirësimin e procesit në mënyrë që të arrihet deri tek rezultatet e prekshme dhe të matshme.

Lista e pjesëmarrësve

Agron Bajrami, *Koha Ditore*

Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Dukagjin Gorani, Qeveria e Kosovës

Aubrey Hamilton, Grupi për Studime Legale dhe Politike

Hydajet Hyseni, Partia Demokratike e Kosovës

Leon Malazogu, Instituti Demokraci për Zhvillim

Engjellushe Morina, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Shkamb Qavdarbasha, Instituti për Politika Zhvillimore

Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave

Besa Shahini, Iniciativa Evropiane për Stabilitet

Nexhmedin Spahiu, TV Mitrovica

Xhelal Svecila, Lëvizja Vetëvendosje

Azem Vllasi, Analist

Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Arber Kuci, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Krystyna Marty, Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme

Norbert Ruetsche, Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme